



Prishtinë: 01.03.2013

Kodi i ZRRE-së: V_511_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_862_09_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_862_09_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 10.01.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2013 nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. (shifra në KEK: DPZ - 9034634), nga Prizreni si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_862_09_12 i datës 25.09.2012.

Arsyetim

Me datë 02.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë përpiluar procesin për pranimin e instalimit elektrik për njehsorin nr. 44150291 si dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 20.02.2009 kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 44150297 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 45275566.

Me datë 14.12.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se konsumatorit duhet t'i regjistrohet njehsori elektrik me numër 45613489 me gjendje TL=01180 kW (tarifa e lartë) dhe TU=00003 kW (tarifa e ulët) në vend të njehsorit të mëparshëm.

Me datë 28.12.2010 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim njehsori ndërsa me datë 29.12.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 45613489 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47444852.

Me datë 23.06.2011 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 45613489 ku është konstatuar se njehsorit elektrik vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar. Pas konstatimit të dhënë në procesverbalin e kalibrimit Departamenti i Faturimit në KEK ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPZ11HP06013 në vlerë prej 1,889.64 €.

Pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit në KEK, Departamenti për Konsumator në KEK me datë 12.08.2011 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalet e kontrollës dhe të kalibrimit.

Konsumatori me datë 26.08.2011 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 25.09.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që



të shkarkojë konsumatorin në shifrën DPZ – 9034634 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPZ11HP06013 të datës 31.01.2011 në vlerë financiare prej 1889.64€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 14.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që sektori i kalibrimit e ka konstatuar vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar dhe mbi bazën e këtij konstatimi KEK, ka ngarkuar konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve. KEK, në pikën 2 të ankesës KEK ka theksuar se edhe analiza e shpenzimit të energjisë elektrike e dëshmon qartë se është keqpërdorur energjia elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01 mars 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu vlerësimin se procesverbali i lëshuar nga sektori i kalibrimit është proces meritator me të cilën konstaton manipulimet e bëra në njehsor elektrik. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha pikave të kundërshtimit konstaton se KEK, me rastin e atakimit të këtij vendimi nuk ka ofruar prova bindëse me të cilën e vërteton faktin se konsumatori i ka shkaktuar humbje nga ajo çka thirret në procesverbalin e kalibrimit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar gjithë rrjedhën e energjisë elektrike të shpenzuar nga ana e konsumatorit me shifër DPZ – 9034634 dhe ka vërejtur se ky konsumator ka pasur shpenzim të rregullt të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 44150291 prej periudhës 05/2008 e deri më 02/2009, ndërsa me ndërrimin e njehsorit elektrik me datë 02.02.2009 kur edhe është vendosur njehsori elektrik nr. 45275566 vërehet qartë se me këtë njehsor elektrik nuk ka pasur shpenzim të rregullt të energjisë elektrike prej periudhës 03/2009 e deri më 03/2011, dhe se nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të evidentuar se pse konsumatori me shifër DPZ – 9034634 prej periudhës 03/2009 – 03/2011 me njehsorin elektrik nr. 45275566 faturohet pa matje/paushall.

Bordi i ZRR po ashtu duhet theksuar se punëtorët e KEK-ut pasi kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik me datë 29.12.2010, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 45613489 dhe e kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 48444852, njehsorin e larguar e kanë dërguar për verifikim në qendrën e kalibrimit dhe pas kontrollës me datë 04.02.2011 kanë konstatuar se njehsorit elektrik vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ndërsa konsumatori me shifër DPZ – 9034634 është ngarkuar me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar vetëm në periudhën 31.01.2011, për shkak të mos prezantimit të njehsorit elektrik nr. 45275566. Andaj sipas kësaj vërehet qartë se fatura e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike i ka arritur konsumatorit para se të bëhet verifikimi nga punëtorët e qendrës së kalibrimit. Kundërshtimi i KEK-ut se konsumatori është ngarkuar me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike sipas konstatimeve të dhëna të Qendrës së Kalibrimit nuk qëndrojnë dhe ajo vërtetohet sipas dëshmive të paraqitura. Duhet theksuar se për periudhën për të cilën KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve konsumatori është faturoar pa matje/paushall dhe se KEK-u është dashur ta ketë parasysh këtë fakt gjatë shqyrtimit të lëndës dhe se edhe para kësaj periudhe KEK-u e ka faturoar pa matje konsumatorin

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit dhe se sipas listave të leximit të KEK-ut vërehet se nga periudha 04/2010 deri më 08/2010 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar që konsumatori ka shpenzim të energjisë elektrike, por që ngarkohet pa matje duke mos dhënë arsyet e mos regjistrimit të shpenzimeve reale mujore përveç në periudhën 07/2010 ka evidentuar që nuk ka qasje si dhe në periudhën 08/2010 ka evidentuar që mungon vula distributive. Në listën e leximit periudha 09/2010 lexuesi ka evidentuar që konsumatori ka bërë ndërrim njehsori, ka vendosur për matje njehsorin



elektrik nr. 45613489 me gjendje të shpenzimeve TL=01180 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=00003 kWh (tarifa e ulët) dhe të njëjtën ka përsëritur deri në periudhën 03/2011

Sa i përket konstatimeve të bëra në ankesën e KEK, se procesverbali i kalibrimit është proces meritator, Bordi i ZRRE-së, konstaton se sipas nenit 8 paragrafi 8.3 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë theksohet: *Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.*

Bordi i ZRRE-së, gjithashtu ka vërejtur se KEK, nuk ka bërë një lexim të saktë të kësaj pike matëse dhe më këtë rast nuk ka vepruar konform dispozitave të nenit 5 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji që përcakton se Operatori i sistemit duhet të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve elektrik.

Bordi i ZRRE-së, konsideron se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit I. (shifra DPZ – 9034634) me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkojë nga borxhi i krijuar në vlerë prej 1889.64 si pasojë e ngarkesës dhe faturimit me rikthim të humbjeve. Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se KEK, në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen saktë se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së me nxjerrjen e këtij vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_862_09_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar